



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës””

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të procesit të konsultimit të projektligjit mirëpret sugjerime nga përfituesit e mbështetjes financiare, nëpërmjet filantropisë, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike e kulturore në Shqipëri, si dhe në diasporë.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Kohëzgjatja e konsultimit nga palët e interesuara është 20 ditë pune nga dita e publikimit në RENJKP, duke filluar nga data **20 qershor 2024** deri më **18 korrik 2024**.

Si të përgjigjeni:

Kontributi juaj me sugjerime konkrete, në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, të dërgohet nëpërmjet:

1. Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik duke klikuar në lidhjen e akteve të publikuara për konsultim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/113>
2. Në adresën e postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të MEPJ: konsultimipublik@mfa.gov.al

Kontakti:

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: konsultimipublik@mfa.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Vendi: Në portalin e Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Datat: 20 ditë nga shpallja e projektaktit për konsultim në RENJKP (20 qershor - 18 korrik 2024).

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës””, vjen si rezultat i miratimit të vendimit nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të

Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën, i cili pushoi së ekzistuari.

Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lindi nevoja për të bërë një analizë të kuadrit ligjor në fuqi për çështjet e diasporës, duke mbajtur në konsideratë nga njëra anë politikën shtetërore dhe objektivat e MEPJ për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të popullsisë shqiptare që jeton jashtë kufijve të RSH-së, dhe nga ana tjetër nevojën për një centralizim të trajtimit të çështjeve të diasporës.

Në përfundim të kësaj analize është konkluduar rishikimi i të gjithë kuadrit ligjor që rregullon çështjet e diasporës, ndër të tjera edhe nevoja për shfuqizimin e ligjit nr. 32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” (në vijim FSHZHD).

FSHZHD është krijuar si një person juridik publik me ligjin nr. 32/2018 “Për fondin shqiptar për zhvillimin e diasporës”, misioni i të cilës lidhet kryesisht me sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

Ky mision në kushtet e kalimit të çështjeve të diasporës në fushën e përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, duhet të realizohet nga kjo ministri që ka edhe tagrin ligjor për realizimin e tij.

FSHZHD ka pasur mungesë fondesh për arsye të përfundimit të afatit të projekteve që subjekti ka realizuar, në kuadër të marrëveshjeve të lidhura nga Këshilli i Ministrave, si dhe projekte të financuara nga Këshilli i Ministrave, donatorë të ndryshëm, si dhe të ardhura nga aktivitete të veta (neni 7 “Kapitali dhe burimet e financimit”, i ligjit nr.32/2018) dhe për rrjedhojë ka humbur qëllimin e krijimit të FSHZHD, ndaj vlerësohet i nevojshëm shfuqizimi i ligjit nr. 32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Propozimet

Në projektligjin që paraqitet për shqyrtim propozohet shfuqizimi i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Pyetjet

Jeni të lutur të dërgoni sugjerimet dhe komentet për projektligjin e shpallur për konsultim publik.

Mirëpresim kontributin Tuaj.